



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**RREGULLORE**

**MBI  
PEZULLIMIN, MBYLLJEN, MARRJEN NË ADMINISTRIM DHE LIKUIDIMIN E  
SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE, DEPOZITARËVE DHE  
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE, SI  
DHE MBI ZËVENDËSIMIN E SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE DHE  
DEPOZITARËVE**

*Miraturar me Vendimin e Bordit nr. 189, datë 16.12.2020*

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave mbi pezullimin, mbylljen, marrjen në administrim dhe likuidimin e shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike si dhe mbi zëvendësimin e shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarit.

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të neneve 21, 47, 114 dhe kreut X dhe kreut XI të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

1. Përkufizimet në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato në Ligjin Nr.56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
2. “Ligji” është Ligji nr. 56/2020, “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”.
3. “Çmimi i kuotës” në këtë rregullore ka të njëjtin kuptim me “Vlera neto e aktiveve për kuotë” të përkufizuar në Ligj.

### **Neni 4**

#### **Fusha e zbatimit**

Kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore zbatohen nga:

- a) Shoqëritë administruese të fondeve të investimeve me ofertë publike;
- b) Shoqëritë administruese e fondit të investimeve alternative;
- c) Depozitarët e fondeve të investimeve me ofertë publike;
- d) Depozitarët e fondeve të investimeve alternative;
- e) Sipërmarrjeve të investimeve kolektive (SIK) me ofertë publike.

## **KREU II**

### **PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE NË SIK ME OFERTË PUBLIKE ME PJESËMARRJE TË HAPUR DHE ME INTERVALE**

#### **SEKSIONI 1**

### **PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES ME VENDIM TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE**

### **Neni 5**

#### **Pezullimi me vendim të shoqërisë administruese të fondeve**

1. Shoqëria administruese e SIK me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale ka të drejtë të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave në përputhje me nenin 114 të ligjit dhe me këtë seksion të kësaj rregulloreje.
2. Nëse shoqëria administruese e fondeve pezullon shlyerjen e kuotave, ajo duhet njëkohësisht të pezullojë edhe shitjen e tyre.

3. Shoqëria administruese e SIK me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale pezullon shlyerjen e kuotave kur, sipas gjykimit të shoqërisë administruese dhe depozitarit, kjo është e nevojshme për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave të fondit.
4. Pezullimi zgjat për aq kohë sa është i justifikuar duke pasur parasysh mbrojtjen e interesave të mbajtësve të kuotave. Në çdo rast pezullimi nuk zgjat më shumë se 20 ditë pune, përveç rasteve kur Autoriteti vendos për një periudhë më të gjatë ose për një pezullim pa afat.
5. Rrethanat e jashtëzakonshme kur pezullimi i shlyerjes mund të konsiderohet i justifikuar janë:
  - a) Ngjarje politike, ekonomike, ushtarake, ngjarjet e politikës monetare ose sociale, greva ose raste të tjera të forcës madhore në ndikimin e të cilave vlerësimi, blerja apo shitja e asetëve të fondit nuk është e mundur të kryhet siç do të kryhej në kushte normale;
  - b) Situata të krizave financiare që çojnë në mbylljen e tregjeve financiare, në të cilat janë investuar një pjesë e konsiderueshme e aktiveve të SIK ose nën fondit;
  - c) Ndërprerja apo mosfunksionimi i mjeteve të zakonshme të komunikimit të përdorura për marrjen e informacionit për të llogaritur vlerën neto të aktiveve të SIK ose nën fondit;
  - d) Raste të tjera të gjykuara nga Autoriteti si të nevojshme për të mbrojtur interesat e kuotambajtësve në një SIK, SIK të veçanta apo nënfond.

## **Neni 6**

### **Pezullimi ose ndërprerja e tregtimit të instrumenteve financiare të portofolit të sipërmarrjes ose nën-fondit**

1. Nëse instrumentet financiare të mbajtura në portofolin e sipërmarrjes ose të nën-fondeve të listuara dhe tregtuara më parë në një treg të rregulluar nuk janë më të listuara ose nëse tregtimi i tyre është pezulluar, ato duhet të vlerësohen më pas duke përdorur metodologjinë e vlerës së drejtë duke marrë parasysh arsyet për pezullimin e tregtimit.
2. Nëse tregu i rregulluar pezullon, për çfarëdo arsye, të gjitha tregtimet e instrumenteve financiare të mbajtura në portofolin e sipërmarrjes ose nënfondit, duke e bërë të pamundur llogaritjen e çmimeve të tregut, nëse vlera e të gjitha instrumenteve financiare të prekura tejkalon 5% ose më shumë të vlerës totale të aktiveve të fondit të investimit me pjesëmarrje të hapur ose me intervale ose të nënfondit, shoqëria administruese e këtij fondi ose nënfondi investimesh pezullon të gjitha shitjet dhe shlyerjet e kuotave të fondit ose nën-fondit të investimeve deri kur tregu të rifillojë tregtimin.

## Neni 7

### Njoftimi i Autoritetit

1. Çdo pezullim i shitjes dhe i shlyerjes së kuotave në përputhje me nenin 114 të ligjit dhe nenin 5 të kësaj rregulloreje, njoftohet nga shoqëria administruese e fondeve në mënyrë elektronike menjëherë në Autoritet.
2. Njoftimi sipas pikës 1 të këtij neni shoqërohet me informacionin dhe analizat e mëposhtme:
  - a) Nëse pezullimi zbatohet për një ose disa sipërmarrje ose nënfonde të caktuara ose për të gjitha sipërmarrjet dhe nënfondet nën administrimin e saj, duke specifikuar çdo sipërmarrje ose nën-fond në fjalë;
  - b) Arsyet e propozimit të pezullimit të shlyerjes dhe se si zbatimi i këtij pezullimi mbron interesat e investitorëve;
  - c) Nëse nevoja për pezullimin e shlyerjes lind nga pamundësia e vlerësimit të kuotave si pasojë e rrethanave që janë jashtë kontrollit të shoqërisë administruese të fondeve;
  - ç) Veprimet alternative apo mbështetjen financiare të mundshme për të shmangur pezullimin;
  - d) Ndryshimet në kushtet e tregut që do të mundësonin rifillimin e shitjes dhe shlyerjes dhe koha kur pritët rifillimi normal i aktivitetit.
3. Depozitari i njofton menjëherë Autoritetit në mënyrë elektronike, miratimin ose refuzimin nga ana e tij të arsyeve të pezullimit, të refuzimit ose zgjatjes së periudhës së pezullimit.

## Neni 8

### Shqyrtimi i pezullimit nga Autoriteti

1. Gjatë shqyrtimit të pezullimit të shitjes dhe të shlyerjes sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, Autoriteti merr në konsideratë nëse ka arsye për të besuar se pezullimi është i nevojshëm në interes të mbrojtjes së publikut ose mbajtësve të kuotave.
2. Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo përfundojnë së ekzistuari arsyet e pezullimit të shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditë pune nga pezullimi, nëse nuk është vendosur ndryshe nga Autoriteti.
3. Nëse shoqëria administruese e fondeve, me miratimin e depozitarit, e konsideron të nevojshme të zgjasë periudhën e pezullimit, ajo i paraqet në mënyrë elektronike Autoritetit, arsyet për propozimin e zgjatjes, së bashku me analizën dhe informacionin përkatës, të paktën pesë ditë pune para mbarimit të periudhës së parashikuar në pikën 2 të këtij neni. Autoriteti lëshon urdhrin për shtyrjen e këtij afati.

4. Gjatë shqyrtimit të arsyeve për pezullimin apo zgjatjen e periudhës së pezullimit sipas pikave më sipër të këtij neni, Autoriteti mund të vendosë kushte të veçanta ose t'i kërkojë shoqërisë administruese të fondeve të ndërmarrë veprime të caktuara që, sipas gjykimit të Autoritetit, reduktojnë pasojat ose dëmin që ky pezullim mund t'ju shkaktojë interesave të mbajtësve të kuotave ose publikut.
5. Autoriteti sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se fillimi i ditës së ardhshme të punës, urdhëron shoqërinë administruese për ta rifilluar shitjen dhe shlyerjen e kuotave, nëse ka arsye për të besuar se kjo është e nevojshme në interes të mbrojtjes së publikut ose të mbajtësve të kuotave.

## **SEKSIONI 2**

### **PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES ME VENDIM TË AUTORITETIT**

#### **Neni 9**

##### **Pezullimi me vendim të Autoritetit**

1. Autoriteti në zbatim të pikës 8, të nenit 114 të ligjit mundet me iniciativë të tij, të urdhërojë pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave të një, disa ose të të gjithave sipërmarrjeve dhe nën-fondeve të administruara nga shoqëria administruese e fondeve.
2. Urdhri sipas pikës 1 të këtij neni lëshohet kur:
  - a) Gjatë mbikëqyrjes rutinë ose gjatë një inspektimi në vend nga Autoriteti, rezulton se janë konstatuar papajtueshmëri me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;
  - b) Sipas gjykimit të Autoritetit, bazuar në shqyrtimin e të gjithë informacionit në dispozicion, ka një vlerësim të pasaktë të aktiveve duke krijuar një çmim të pasaktë;
  - c) Sipas gjykimit të Autoritetit, bazuar në shqyrtimin e të gjithë informacionit që ka në dispozicion, ka ndodhur një mashtrim, mosveprim ose neglizhencë (*malpractice*);
  - ç) Shoqëria administruese kryen shitje të vazhdueshme të kuotave pa i ofruar investitorëve prospektin përkatës të SIK dhe dokumentin e informacionit kryesor për investitorin;
  - d) Rrethanat jashtë kontrollit të shoqërisë administruese të fondit ose Autoritetit, e bëjnë të pamundur vlerësimin e kuotave në një mënyrë që është e drejtë ndaj personave që blejnë kuota, ndaj mbajtësve të kuotave dhe ndaj personave që i shlyejnë këto kuota në çdo kohë;
  - dh) Sipërmarrja ose nënfondi detyrohet të shesë aktivet për të përballuar një numër të lartë kërkesash për shlyerje krahasuar me shlyerjet neto mesatare ditore, gjatë një periudhe tre mujore dhe si pasojë shitja e aktiveve do të dëmtonte investitorët e sipërmarrjes ose të nën-fondit nëse shlyerjet do të lejoheshin të vazhdonin.

3. Nëse pezullimi është rezultat i rastit të përcaktuar në pikën 2, shkronja a) të këtij neni, urdhri i Autoritetit përmban çdo veprim korigjues të çdo lloji që shoqëria administruese e fondit dhe/ose depozitari duhet të ndërmarrin, me qëllim që të mundësohet shitja ose shlyerja e kuotave dhe afatin brenda të cilit duhet të ndërmerret një veprim i tillë.
4. Autoriteti urdhëron shoqërinë administruese të fondeve dhe depozitarin, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se e njëjta ditë pune, për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes, duke përcaktuar një, disa apo të gjitha sipërmarrjet ose nën-fondet përkatëse për të cilat do të zbatohet urdhri, si dhe parashtron arsyet për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes. Urdhri duhet të përcaktojë nëse pezullimi është me ose pa afat të caktuar.
5. Nëse Autoriteti e gjykon të nevojshme, me qëllim mbrojtjen e interesave të publikut ose mbajtësve të kuotave ose në rastet e forcës madhore, urdhëron një, disa ose të gjitha shoqëritë administruese të fondeve dhe depozitarët, që të zgjasin periudhën kohore të pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së sipërmarrjeve ose nën fondeve përkatëse, duke përcaktuar këtë periudhë ose duke kërkuar që pezullimi të bëhet pa afat.

### **SEKSIONI 3**

#### **PEZULLIMI I SHITJES DHE SHLYERJES NGA NJË SIPËRMARRJE KRYESORE OSE NËNFOND KRYESOR**

##### **Neni 10**

##### **Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes nga një sipërmarrje kryesore ose nënfond kryesor**

1. Në rast se sipërmarrja kryesore ose nënfondi kryesor pezullon shitjen dhe shlyerjen sipas nenit 5 ose nenit 9 të kësaj rregulloreje, secila nga sipërmarrjet furnizuese ose nënfondet furnizuese që investojnë në sipërmarrjen kryesore ose nënfondin kryesor duhet të pezullojnë shitjen dhe shlyerjen e kuotave të tyre.
2. Shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit furnizues informon Autoritetin në mënyrë elektronike sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se në të njëjtën ditë pune para mbylljes së orarit zyrtar.

### **SEKSIONI 4**

#### **NJOFTIMI I MBAJTËSVE TË KUOTAVE PËR PEZULLIMIN E SHITJES DHE SHLYERJES SË KUOTAVE**

## Neni 11

### Njoftimi i pezullimit

1. Shoqëria administruese e fondeve, pasi Autoriteti ka shqyrtuar pezullimin sipas pikës 5 të nenit 8 të kësaj rregulloreje, informon mbajtësit e kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit përkatës në lidhje me pezullimin e shitjes ose shlyerjes, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se ditën e ardhshme të punës pas fillimit të pezullimit.
2. Ky njoftim kryhet si më poshtë:
  - a) Duke e publikuar në një gazetë të përditshme të shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve;
  - b) Nëpërmjet komunikimit elektronik të të gjithë kanalet e shitjes dhe të shpërndarjes, duke përfshirë degët dhe agjentët e lidhur;
  - c) Në rastin e sipërmarrjes kryesore ose nënfondeve, nëpërmjet komunikimit elektronik të çdo sipërmarrjeje furnizuese ose nënfondi që kryen investime në atë sipërmarrje kryesore ose nënfond;
  - ç) Nëpërmjet komunikimit elektronik të rregullatorëve të huaj nëse sipërmarrja ose nën-fondi shet jashtë Republikës së Shqipërisë.
3. Gjatë kryerjes së njoftimit shoqëria administruese e fondeve duhet të:
  - a) Informojë mbajtësit e kuotave në lidhje me rrethanat e jashtëzakonshme që ndikuan në pezullim;
  - b) Informojë në mënyrë të qartë, të drejtë dhe jo mashtruese, duke përcaktuar se ku mund të merret informacioni sipas pikës 4 të këtij neni.
4. Shoqëria administruese e fondeve publikon detaje të mjaftueshme që nevojiten për informimin e mbajtësve të kuotave në lidhje me pezullimin, të drejtat e tyre gjatë pezullimit dhe kohëzgjatjen e këtij procesi, në faqen e saj të internetit dhe në të gjitha kanalet e shitjes dhe shpërndarjes, përfshirë degët dhe agjentët e lidhur, si dhe çdo sipërmarrje furnizuese ose nën-fond.
5. Në përjashtim të pikës 1 të këtij neni, në rast se shoqëria administruese e fondeve është pezulluar, marrë në administrim, shpallur në falimentim ose është në likuidim, administruesi i përkohshëm dhe likuiduesi është përgjegjës për njoftimin sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni dhe për publikimin sipas pikës 4 të këtij neni dhe për përmbushjen e kërkesave të këtij kreu.
6. Në rastin e pezullimit të kërkuar nga Autoriteti sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje, Autoriteti publikon sa më shpejt në faqen zyrtare të tij vendimin për pezullimin dhe arsyet e pezullimit duke përfshirë periudhën e pezullimit, jo më vonë se brenda të njëjtës ditë pune të lëshimit të urdhrin që përcakton pezullimin.

## SEKSIONI 5

### DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE DHE TË DEPOZITARIT

#### Neni 12

##### **Detyrimet e përgjithshme të shoqërisë administruese të фондеве**

Shoqëria administruese e фондеве duhet:

- a) Të ketë një procedurë të shkruar e cila duhet të ndiqet në situatat e pezullimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave, dhe duhet të përfshijë planin e komunikimit me depozitarin, Autoritetin, dhe mbajtësit e kuotave;
- b) Të publikojë në prospektin e çdo fondi të saj, rrethanat kur pezullimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave mund të ndodhë, si dhe mënyrën sesi ky pezullim do t'i komunikohet kuotambajtësve në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- c) Të njoftojë menjëherë Autoritetin dhe të raportojë çdo ditë nivelin e shlyerjeve neto, si vlerë dhe si përqindje e vlerës neto të aseteve, për 10 ditët vijuese të punës nëse shlyerjet neto janë negative dhe përbëjnë një ose më shumë se një përqind të vlerës së aseteve neto në çdo ditë për më shumë se 5 ditë pune radhazi, ose përbëjnë 5 përqind ose më shumë të vlerës së aseteve neto të fondit në një ditë pune;
- d) Të paraqesë brenda një ore pranë Autoritetit çmimin e kuotës së fondit, i cili është rakorduar më parë me depozitarin me rifillimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave.

#### Neni 13

##### **Detyrimet e shoqërisë administruese të фондеве dhe të depozitarit gjatë periudhës së pezullimit**

Shoqëria administruese e фондеве dhe depozitari gjatë periudhës së pezullimit kanë detyrimin që të vazhdojnë të ndjekin funksionimin e sipërmarrjes ose nën-fondit.

#### Neni 14

##### **Kërkesat për shitje ose shlyerje të marra nga shoqëria administruese e фондеве para dhe gjatë periudhës së pezullimit**

1. Në lidhje me transaksionet e papërfunduara para fillimit të pezullimit, nëse një shitje ose shlyerje është kërkuar por nuk është përfunduar, shoqëria administruese informon investitorët që ata mund të:
  - a) Anulojnë kërkesën pa asnjë detyrim të mëtejshëm; ose



- b) Presin derisa periudha e pezullimit të ketë përfunduar dhe të pranojnë çmimin e kuotës të llogaritur për datën e bërjes së kërkesës, dhe kur nuk është e mundur, çmimin tjetër të radhës të llogaritur pas kërkesës për shlyerje.
2. Në lidhje me kërkesat për shitje ose shlyerje gjatë periudhës së pezullimit, shoqëria administruese informon investitorët se:
    - a) Ata mund të zgjedhin të mos vazhdojnë me transaksionin pa detyrime të mëtejshme; ose
    - b) Të presin derisa periudha e pezullimit të ketë përfunduar dhe të pranojnë çmimin tjetër të radhës të llogaritur pas kërkesës për shlyerje.

## **Neni 15**

### **Trajtimi i drejtë i investitorëve**

1. Kërkesat për shlyerje të marra gjatë periudhës së pezullimit të shitjes dhe shlyerjes, regjistrohen nga shoqëria e administrimit të fondeve sipas rendit kronologjik të pranimit të kërkesës.
2. Të gjithë investitorët që kanë kërkesa të papërfunduara për shitje ose shlyerje dhe të cilët nuk kanë zgjedhur të anulojnë transaksionin e tyre, trajtohen në mënyrë të barabartë dhe në bazë të kronologjisë kur është marrë urdhri i tyre për kryerjen e transaksionit.

## **SEKSIONI 6**

### **RIFILLIMI I SHITJES DHE I SHLYERJES**

## **Neni 16**

### **Rifillimi i shitjes dhe i shlyerjes**

1. Shoqëria administruese e fondeve informon menjëherë Autoritetin në mënyrë elektronike, mbi rifillimin e tregtimit të kuotave që janë pezulluar sipas Seksionit 1 të këtij Kreu.
2. Në rastin e rifillimit të shitjes dhe shlyerjes së sipërmarrjes kryesore ose nënfondit kryesor pas një pezullimi sipas nenit 10 të kësaj rregulloreje, secila nga sipërmarrjet furnizuese ose nënfondet që investojnë në sipërmarrjen kryesore ose nënfondin kryesor, duhet të rifillojnë shitjen dhe shlyerjen e kuotave të tyre. Shoqëria administruese e sipërmarrjes furnizuese ose nënfondit furnizues informon menjëherë Autoritetin në mënyrë elektronike.

3. Me rifillimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave, shoqëria administruese e fondeve duhet të paraqesë brenda një ore pranë Autoritetit çmimin e kuotës së fondit, i cili është rakorduar më parë me depozitarin.
4. Çmimi i kuotës me të cilin do të kryhet shitja dhe shlyerja për kërkesat e bëra gjatë periudhës së pezullimit do të jetë çmimi tjetër i radhës i llogaritur menjëherë pas rifillimit të shitjes dhe shlyerjes.
5. Çmimi i kuotës me të cilin do të kryhet shitja dhe shlyerja e transaksioneve të papërfunduara të kërkesave të bëra para fillimit të periudhës së pezullimit do të jetë, çmimi i kuotës së llogaritur për datën e bërjes së kërkesës, dhe kur nuk është e mundur, çmimi tjetër i radhës i llogaritur menjëherë pas rifillimit të shitjes dhe shlyerjes.
6. Pas përfundimit të pezullimit të shitjes dhe të shlyerjes, pagesat që rrjedhin nga kërkesat për shlyerje të grumbulluara gjatë pezullimit, duhet të kryhen brenda shtatë ditëve kalendarike nga dita e llogaritjes së çmimit të kuotës pas rifillimit të shitjes dhe shlyerjes të kuotave.

#### **Neni 17**

#### **Njoftimi për rifillimin e shitjes dhe të shlyerjes**

1. Shoqëria administruese e fondeve informon menjëherë mbajtësit e kuotave të sipërmarrjes ose nënfondit përkatës në lidhje me rifillimin e shitjes ose shlyerjes sipas nenit 16 të kësaj rregulloreje.
2. Shoqëria administruese e fondeve gjithashtu informon investitorët që kërkesat e tyre të pazgjidhura për shitjen ose shlyerjen tashmë mund të përmbushen.
3. Ky njoftim kryhet me të njëjtën mënyrë të përdorur për të njoftuar pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes sipas pikës 2 të nenit 11, kësaj rregulloreje.

#### **Neni 18**

#### **Pamundësia e rifillimit të shitjes dhe shlyerjes së kuotave**

Në rast se rifillimi nuk është i mundur për ndonjë ose të gjitha fondet me pjesëmarrje të hapur dhe me intervale me ofertë publike, Autoriteti kërkon ndryshimin e këtyre fondeve në fonde me pjesëmarrje të mbyllur me ofertë publike ose që këto fonde të mbyllen dhe të likuidohen.

**KREU III**  
**MBYLLJA DHE LIKUIDIMI VULLNETAR I SIK ME OFERTË PUBLIKE DHE**  
**NËNFONDEVE**

**SEKSIONI 1**

**MBYLLJA E NËNFONDIT TË SIK ME OFERTË PUBLIKE ME PJESËMARRJE TË**  
**HAPUR OSE ME INTERVALE**

**Neni 19**

**Mbyllja e nënfondit të SIK me ofertë publike me pjesëmarrje të hapur ose me intervale**

1. Mbyllja e nënfondit kryhet në rrethanat e përcaktuara në shkronjat a dhe b, pikës 1, të nenit 173 të ligjit.
2. Kërkesa për mbylljen e nënfondit parashtrohet në Autoritet.
3. Autoriteti njofton me shkrim shoqërinë e administrimit të nënfondit për miratimin e mbylljes brenda tre muajve nga marrja e kërkesës së plotë.
4. Procedura e mbylljes së nënfondit kryhet në përputhje me nenin 176 të ligjit.
5. Njoftimi i mbajtësve të kuotave të shoqërisë së investimeve bëhet sipas pikës 18 të nenit 177 të ligjit në formë shkresore ose elektronike në adresat respektive postare ose elektronike. Publikimi i njoftimit bëhet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve.
6. Shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari njoftojnë autoritetin me të përfunduar mbylljen e nënfondit dhe dorëzojnë një llogari përfundimtare të përditësuar deri në datën e mbylljes, e cila është edhe dita e fundit e kësaj llogarie. Në të njëjtën kohë, shoqëria administruese i kërkon autoritetit heqjen e licencës dhe përditësimin e evidencave përkatëse.

**SEKSIONI 2**

**LIKUIDIMI VULLNETAR I FONDIT TË INVESTIMEVE ME OFERTË PUBLIKE**

**Neni 20**

## **Likuidimi vullnetar i fondit të investimeve me ofertë publike**

1. Fondi i investimeve me ofertë publike, i cili ka aftësi pagueuse, mund të likuidohet në mënyrë vullnetare në përputhje me nenin 173 të ligjit.
2. Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit të investimeve me ofertë publike i parashtrohet Autoritetit në përputhje me parashikimet e nenit 175 të ligjit.
3. Autoriteti njofton shoqërinë administruese të fondeve për miratimin e kërkesës së likuidimit vullnetar brenda 3 muajve, pas marrjes së kërkesës, së bashku me dokumentacionin e plotë, sipas pikës 5, të nenit 175 të ligjit.
4. Procedura e likuidimit vullnetar kryhet në përputhje me nenin 176 të ligjit.
5. Njoftimi i mbajtësve të kuotave të shoqërisë së investimeve bëhet sipas pikës 18 të nenit 177 të ligjit në formë shkresore ose elektronike në adresat respektive postare ose elektronike. Publikimi i njoftimit bëhet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondit.
6. Shoqëria administruese dhe depozitari njoftojnë autoritetin me të përfunduar likuidimi vullnetar i fondit të investimeve dhe dorëzojnë një llogari përfundimtare të përditësuar deri në datën e mbylljes, e cila është edhe dita e fundit e kësaj llogarie. Në të njëjtën kohë, shoqëria administruese i kërkon autoritetit heqjen e licencës dhe përditësimin e evidencave përkatëse.

### **KREU IV**

## **LIKUIDIMI VULLNETAR I SHOQËRISË SË INVESTIMIT DHE SHOQËRISË ADMINISTRUESE TË FONDEVE**

### **Neni 21**

#### **Likuidimi vullnetar i shoqërisë së investimit dhe shoqërisë administruese të fondeve**

1. Kërkesa për likuidimin vullnetar të shoqërisë së investimeve me ofertë publike ose shoqërisë administruese të fondeve i parashtrohet Autoritetit në përputhje me kërkesat e nenit 177 të ligjit. Kërkesa përfshin informacion në lidhje me likuiduesit e propozuar, të cilët duhet të përmbushin kërkesat e pikave 3 dhe 4 të nenit 177 të ligjit.
2. Emërohen si likuidues të shoqërisë administruese të fondeve të paktën 2 persona fizikë, të aftë dhe të përshtatshëm për kryerjen e detyrave, të cilët miratohen paraprakisht nga autoriteti dhe kanë përvojën dhe kualifikimet e kërkuara.

3. Likuiduesit e shoqërisë së investimeve me ofertë publike të cilët miratohen nga Autoriteti mund të jenë, ose likuidues person fizik ose depozitari i shoqërisë së investimeve.
4. Likuiduesit mund të shkarkohen dhe të zëvendësohen sipas të njëjtave kushte të parashikuara në dispozitat për emërimin e tyre.
5. Autoriteti merr vendim dhe njofton me shkrim shoqërinë e investimeve ose shoqërinë administruese të fondit për miratimin e likuidimit vullnetar brenda 3 muajve nga data e marrjes së kërkesës së plotë. Autoriteti miraton likuidimin vullnetar, vetëm nëse gjykon se mund të paguhet të gjitha detyrimet kundrejt pronarëve dhe kreditorëve të shoqërisë. Gjatë kësaj periudhe, personat kyç të shoqërisë kryejnë detyrat e zakonshme, por nuk angazhohen në detyrime të reja kundrejt të tretëve.
6. Njoftimi i mbajtësve të kuotave të shoqërisë së investimeve bëhet sipas pikës 18 të nenit 177 të ligjit, në formë shkresore ose elektronike në adresat respektive postare ose elektronike. Publikimi i njoftimit bëhet në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondit dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit.
7. Përfundimi i likuidimit vullnetar duhet të kryhet brenda 12 muajve duke përfshirë kryerjen e pagesave të detyrimeve të shoqërisë kundrejt kreditorëve dhe aksionerëve. Me përfundimin e likuidimit, likuiduesi dorëzon në Autoritetit një raport për procedurën e likuidimit dhe një propozim për shpërblimin e punës së tij.
8. Nëse Autoriteti nuk e miraton raportin, likuiduesi ndjek rekomandimin e bërë nga Autoriteti.
9. Pas miratimit nga Autoritetit të raportit të likuiduesit, Autoriteti heq licencën e dhënë shoqërisë.

## **KREU V**

### **ZËVENDËSIMI I SHOQËRIVE ADMINISTRUESE TË FONDEVE DHE DEPOZITARËVE**

#### **Neni 22**

##### **Zëvendësimi i shoqërisë administruese të фондеve dhe depozitarit**

1. Shoqëria administruese e фондеve me vendimin e saj, me vendim të Autoritetit, ose për shkak të falimentimit të saj mund t'ia transferojë të drejtën për administrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive një shoqërie tjetër administruese.
2. Shoqëria në të cilën transferohet e drejta për administrimin e SIK mund të jetë:

- a) Një shoqëri administruese ekzistuese që kryen aktivitet për administrimin e fondeve;
  - b) Një shoqëri e re administruese e fondeve, rezultat i bashkimit të shoqërisë që administron SIK, aktiviteti i të cilës do të transferohet, me një shoqëri tjetër administruese;
  - c) Një shoqëri administruese e përcaktuar me urdhër nga Autoriteti.
3. Depozitari që dëshiron të zgjidhë kontratën e veprimtarisë si depozitar ose të zgjidhë marrëveshjen për shërbimet depozitare lidhur me një ose disa sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, njofton me shkrim, jo më pak se tre muaj përpara datës së zgjidhjes së propozuar të kontratës, Autoritetin dhe shoqërinë administruese dhe në rastin e shoqërisë së investimeve, njofton gjithashtu personat kyç të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike të cilave u ofron shërbime.
4. Depozitari në njoftimin me shkrim që i dërgon Autoritetit, sipas parashikimeve të pikës 3, të këtij neni, përfshin gjithashtu çdo çështje lidhur me veprimtarinë e sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike që depozitari ka marrë dijeni gjatë kryerjes së funksioneve të tij dhe që, sipas mendimit të depozitarit, rrezikon të dëmtojë aftësinë e sipërmarrjes për të vepruar në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

## **Neni 23**

### **Miratimi i transferimit të shoqërive administruese të fondeve dhe depozitarëve**

1. Autoriteti jep miratimin e tij me shkrim përpara transferimit duke deklaruar se:
  - a) Nuk ka kundërshtim për transferimin;
  - b) Shoqëria administruese e fondeve ose depozitari që do të zëvendësojë shoqërinë administruese ose depozitarin ekzistues nuk është subjekt i masave mbikëqyrëse për korigjimin e shkeljeve të ligjit ose rregulloreve në zbatim të tij.
2. Para dhënies së miratimit sipas pikës 1 të këtij neni në Autoritet, shoqëria administruese e fondeve duhet të paraqesë me shkrim:
  - a) Në rastin e zëvendësimit të shoqërisë administruese të fondeve:
    - i) Vendimin e jashtëzakonshëm të aksionarëve;
    - ii) Të gjitha arsyet për marrjen e këtij vendimi;
    - iii) Informacion mbi shoqërinë që do t'i transferohet e drejta e administrimit të SIK dhe kriteret e përzgjedhjes;
    - iv) Projekt-kontratën me shoqërinë që do t'i transferohet e drejta e administrimit të SIK.
  - b) Në rastin e zëvendësimit të depozitarit:
    - i) Vendimin e shoqërisë administruese apo të personave kyç për zëvendësimin e depozitarit;
    - ii) Projekt-kontratën e shoqërisë me depozitarin zëvendësues;
    - iii) Informacion mbi depozitarin zëvendësues dhe kriteret e përzgjedhjes.

3. Para dhënies së miratimit sipas pikës 1 të këtij neni për transferimin e shërbimeve depozitare, në Autoritet duhet të paraqiten me shkrim deklaratat e mëposhtme:
  - a) Nga shoqëria administruese e fondit:
    - i) Se në dijeninë e saj, aktiviteti i depozitarit zëvendësues është në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi;
    - ii) Se transferimi nuk është bërë për arsye që nuk i janë bërë të njohura depozitarit zëvendësues;
  - b) Nga depozitari që do të zëvendësohet:
    - i) Se në dijeninë e tij, shoqëria administruese e fondeve dhe sipërmarrja në fjalë janë në përputhje me ligjin dhe rregulloret në fuqi;
    - ii) Që nuk ka pengesa ligjore ose teknike për transferimin e aktiveve të depozitari zëvendësues.
4. Pas miratimit sipas pikës 1 të këtij neni, depozitari dhe shoqëria zëvendësuese administruese e fondeve ose shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari zëvendësues lidhin menjëherë një kontratë për transferimin e administrimit. Kjo marrëveshje përmban një përshkrim të të gjitha procedurave dhe veprimeve që duhet të ndërmerren në lidhje me transferimin e shërbimeve të administrimit ose të depozitarit.
5. Në rastin e transferimit të aktivitetit për administrimin e fondeve, depozitari dhe shoqëria zëvendësuese administruese e fondeve duhet që në ditën pasardhëse të punës nga dita e marrjes së miratimit nga Autoriteti të kërkesës për transferim dhe në çdo rast para datës së transferimit të administrimit, të publikojnë informacione për transferimit e ardhshëm, duke përfshirë:
  - a) Një shpjegim të shkurtër të arsyeve për transferimin e kontratës të administrimit të fondeve;
  - b) Informacion të përgjithshëm mbi shoqërinë e përzgjedhur të administrimit të fondeve dhe kriteret e përzgjedhjes;
  - c) Informacion për të gjitha procedurat dhe veprimet që duhet të ndërmerren në lidhje me transferimin e administrimit të fondeve, duke specifikuar datën e transferimit të fondeve në një shoqëri tjetër administruese fondesh.
6. Publikimi sipas pikës 5 të këtij neni bëhet nëpërmjet botimit të informacionit të kërkuar në faqen e internetit të shoqërisë administruese të fondeve.
7. Transferimi i administrimit të fondeve ose i depozitarit të sipërmarrjes së investimeve kolektive me ofertë publike është një ndryshim thelbësor sipas nenit 65 dhe nenit 77 të ligjit dhe zbatohen dispozitat e nenit 92 të ligjit.

**KREU VI**  
**MARRJA NË ADMINISTRIM TË SHOQËRIVE TË INVESTIMEVE DHE TË**  
**SHOQËRIVE TË ADMINISTRIMIT TË FONDEVE**

**Neni 24**

**Marrja në administrim me vendim të Autoritetit**

1. Autoriteti, sipas nenit 178 të ligjit, nxjerr urdhër për shoqërinë e investimit ose shoqërinë administruese të fondeve për marrjen në administrim sipas përcaktimeve dhe kushteve të parashtruara në Seksionin 4 të Kreut XI të ligjit.
2. Marrja në administrim përfundon në rrethanat e përcaktuara në nenin 185 të ligjit.
3. Në rast se mbyllja sipas pikës 2 të këtij neni, me vendim të Autoritetit, rezulton në vendosjen e shoqërisë administruese të shoqërisë së investimeve ose shoqërisë administruese të fondeve, në likuidim të detyrueshëm, zbatohen dispozitat e kreut VII të kësaj rregulloreje dhe dispozitat e ligjit.

**KREU VII**

**LIKUIDIMI I DETYRUESHËM I SHOQËRISË SË INVESTIMIT DHE SHOQËRISË**  
**ADMINISTRUESE TË FONDEVE**

**Neni 25**

**Vendimi i Autoritetit për likuidim të detyrueshëm**

1. Autoriteti merr vendim për vendosjen në likuidim të detyrueshëm të subjekteve të licencuara, në zbatim të këtij ligji, kur konstaton se ekzistojnë një ose më shumë prej rrethanave të mëposhtme:
  - a) Personi i licencuar nuk është në gjendje të shlyejë borxhet e veta brenda afatit;
  - b) Personi i licencuar kryen ose ka kryer veprimtari në shkelje të ligjit;
  - c) Autoriteti gjykon se është vendimi i duhur dhe i drejtë që personi i licencuar të ndërpresë veprimtarinë e tij;
  - d) Kjo procedurë rekomandohet në kuadër të një procesi të përfunduar rimëkëmbjeje dhe rehabilitimi.
2. Autoriteti për të garantuar mbrojtjen e investitorëve në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike njëkohësisht mund të urdhërojë që administrimi i sipërmarrjeve me ofertë publike të transferohet nga shoqëria administruese e fondeve që hyn në likuidim të detyrueshëm sipas pikës 1 të këtij neni në një shoqëri tjetër administruese të fondeve siç parashikohet në Kreun V të kësaj rregulloreje.
3. Autoriteti cakton si likuidues në shoqërinë e administrimit të fondeve ose shoqërinë e investimeve, personat që plotësojnë kërkesat e pikës 2 dhe 3 të nenit 21, të kësaj rregulloreje.



4. Likuidimi i detyrueshëm i shoqërisë së investimit ose i shoqërisë së administrimit të fondeve kryhet në përputhje me Seksionin 5 të Kreut XI të ligjit.

## **KREU VIII DISPOZITA TË TJERA**

### **Neni 26**

#### **Shfuqizime**

Rregullorja nr. 154 datë 29.09.2016, “Mbi pezullimin e shitjes dhe shlyerjes së kuotave në fondet e investimeve” shfuqizohet.

### **Neni 27**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.